



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel:038/20043814

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY
ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e tretë e jashtëzakonshme e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 27.08.2020 (e Enjte), në sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 14. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 2. Besa Ferati, LDK; | 15. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 3. Naim Behlulaj, LDK; | 16. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 4. Njomza Demaj, LDK; | 17. Labinot Aliaj, PDK; |
| 5. Haki Podrimaj, LDK; | 18. Arben Kabashi, PDK; |
| 6. Selajdin Bytyqi, LDK; | 19. Ajshe Metaj, PDK; |
| 7. Riza Dreshaj, LDK; | 20. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 8. Ruzhdi Metaj, LDK; | 21. Lavdiqe Bujupaj, VV; |
| 9. Valbona Demaj, LDK; | 22. Arif Elshani, IQ; |
| 10. Edona Lubeniqi, LDK; | 23. Radoš Repanović, SL; |
| 11. Naim Imeraj, AAK; | 24. Radenko Belošević, RB dhe |
| 12. Nexhmedin Balaj, AAK; | 25. Slaviša Maliković, SM. |
| 13. Misin Berisha, AAK; | |

Në mbledhje të ishin të pranishëm Kryetari z. Haki Rugova, drejtorë të drejtorive të komunës, zyrtarë komunal, dhe media (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe në CD-të e xhirimit, të cilat gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti të pranishmit, hapi punimet për mbledhjen e jashtëzakonshme, të Legjislacionit të VI-të bazuar në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, statutin e komunës dhe kërkesën e Kryetarit të Komunës. Dihet së në mbledhjet e jashtëzakonshme sipas rregullores dhe ligjit është një pikë e rendit të ditës ku diskutohet dhe debatohet lidhur me aprovimin apo mos aprovimin e saj.

Rendi i ditës

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për Destinimin e mjeteve Buxhetore për Mallra dhe Shërbime dhe Projektet Kapitale nga Rezervat Buxhetore (sipas nenit 5 të Ligjit për Rishikimin e Buxhetit).

Kryesuesi, njoftoi se për këtë mbledhje munguan 2 (dy) këshilltarë. Zenel Shatri pa arsye dhe Agron Avdijaj me lajmërim. Gjithsej në mbledhje ishin të pranishëm 25 (njëzetë e pesë) këshilltarë.

Shqyrtimi i pikës së rendit të ditës.

Kryesuesi, në këtë mbledhje propozojë këtë pikë rend dite 'Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për Destinimin e mjeteve Buxhetore për Mallra dhe Shërbime dhe Projektet Kapitale nga Rezervat Buxhetore'. Shumica veç jeni në dijeni për këto rezerva janë mjete të cilat kanë qenë të destinuara për zbatimin e Ligjit për Paga i cili për arsye që veç dihen nuk ka hyrë në fuqi, prandaj niveli qendror, Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur që këto mjete ti bartë në Komuna, që Komuna të bëjë destinimin e tyre, për nevojat e tyre aty ku e shohin më të arsyeshme. Prandaj Kryetari i Komunës me stafin e tij ka bërë këtë Propozim -Vendim për destinimin e këtyre mjeteve dhe sot jemi taku që të vendosim për miratimin e këtij Propozim-Vendimi. Fjalën e ka Kryetari z. Haki Rugova.

Kryetari, unë dëshiroj me ju përshëndet të gjithëve ju këshilltarë komunal që jeni sot këtu, e di që keni marrë qëndrim që nuk do të ketë mbledhje brenda muajit gusht që kështu është edhe me kalendar, po quhet e jashtëzakonshme, kemi pas nevojë të takohemi për shkak të disa propozimeve, një vendim i ri që duhej të sillej sot në Kuvend, e kur të është e jashtëzakonshme duhet edhe me u sjellë pak edhe në mënyrë të jashtëzakonshme. Kështu që arsyeja pse ka ardhë deri te këto mjete shtesë nga rezervat 600 e sa mijë euro janë aty, unë ja kisha dhënë fjalën drejtorit për detaje atëherë unë mund të flas se pse jemi përcaktuar në këto projekte dhe arsyet e tjera.

Kryesuesi, faleminderit Kryetar! drejtori Hysni Maxharraj e ka fjalën.

Kryetari, shpjego se nga është burimi dhe cila është arsyeja.

Hysni Maxharraj, Falënderon Kryetarin, përshëndet Kryesuesin dhe të gjithë të pranishmit, dhe prezanton : Propozim Vendimin për Destinimin e mjeteve Buxhetore për Mallra dhe Shërbime dhe Projektet Kapitale nga Rezervat Buxhetore (sipas nenit 5 të Ligjit për Rishikimin e Buxhetit).

Pra siç tha edhe kryesuesi, këto janë mjete që kanë qenë vitin e kaluar të planifikuara për paga të shërbyesve civil për Ligjin e ri të Pagave siç jeni në dijeni Ligji nuk ka kaluar dhe Qeveria nuk i ka marrë këto mjete për me i dërguar në suficit por ja u ka kthyer komunave në rezerva dhe ja u ka lënë duart e hapura që këto mjete ti transferojnë në projekte kapitale në mallra dhe shërbime dhe subvencione, përveç një kategorie ekonomike paga dhe transfere. Faleminderit!

Radoš Repanović, dhe Radenko Belošević largohen nga mbledhja në ora 10:20.

Kryesuesi, faleminderit drejtor! Të nderuar anëtarë të Kuvendit, nëse dikush e dëshiron fjalën urdhëroni? Është lajmëruar Arif Elshani.

Arif Elshani, përshëndetje për të gjithë! Po shihet që investime kapitale janë paraparë 500,000.00€ një për ujësjellës tjetra për rrugë. Ndoshta kisha pas qejf me ditë të specifikuar se ku do të shkojnë ato projekte, dy projekte ka 250,000.00 € a janë të specifikuara apo janë lënë të hapura sipas nevojave kjo po më intereson. Faleminderit!

Kryesuesi, faleminderit Arif. Ndoshta edhe dikush tjetër ka ndonjë pyetje?
Kryetari e ka fjalën!

Kryetari, ne kemi pasur shumë diskutime me Qeverinë, me kryetarët e Komunave së bashku para 2-3 ditëve e kemi pasur një takim të përbashkët, dhe unë e kam parë se si kanë lëvizur komunat tjera, d.m.th ka Komuna që i kanë dërguar komplet krejt shumën e mjeteve në Mallra dhe Shërbime lidhur me pandeminë. Merreni me mend ka raste kur kryetarët e Komunave afër 1 milion euro dëshiron me ble material sanitar aty dhe do me i grumbulluar me kamion. Unë nuk e kam pasur këtë ide, e kam parë si ka vepruar Peja dhe krejt ata kolegët aty dhe shuma më e lartë është pikërisht në investime kapitale, çdokund investimet kapitale janë nën 40% e te ne është më e lartë se 70% arsyeja është kjo: ne kur kemi ndarë për pandemi, për virusin Covid-19 kur kemi ndarë mjete i kemi ndarë prej Mallra dhe Shërbime. D.m.th. i kemi mbuluar dhe kemi shfrytëzuar edhe donatorë kështu që ne nuk kemi heq keq asgjë rreth situatës së pandemisë. Ne prapë do të investojmë, edhe një shumë është e ndarë për Arsim, por do të kemi mundësi ende të vazhdojmë ne me investime të tilla. Kështu që janë përzgjedh dy projekte kapitale me një shumë 250,000.00 € njëri dhe 250,000.00 € tjetri, nuk janë dhënë krejt paushall këto

vlerësime, kemi qenë të detyruar të shkojmë me ato kode ekzistuese buxhetore se nuk mund të hapim kode të reja por kjo ka qenë ajo që nuk e pranon Ministria, kështu që kemi shkuar në këtë variant. Shuma 250,000.00€ shkon në ujësjellësin e 'Mbi vadës' është fjala për rrjetet sekondare të atyre fshatrave që nuk kanë rrjet sekondar, po flas për :Cerkolezë, Syrganë, Padalishtë, Kërrnina e poshtme e epërme d.m.th. dy Kërrninat, se në këtë projektin ekzistues është në përfundim nuk ka rrjet sekondar, kështu që e kemi thirrur kompaninë, edhe janë bërë disa para masa, janë përgatitur paraprakisht se ne e kemi ndërmend që secila lagje nga rezervari i Cerkolezit që është në përfundim atje lartë të shkojnë të furnizohen të gjitha pjesët në këtë rrjet sekondar, edhe është një kosto e cila, unë kam pasur një projekt paraprak para 2-3 vjet të bërë por kreditori Austriak nuk kanë pranuar të hyn në 110 gypat që janë edhe kemi shkuar në këtë variant. Nuk do të dëshiroja që nesër të lëshohet uji aty d.m.th. ky ujësjellës dhe njerëzit mos ta kenë ujin.

D.m.th. me këto fshatra me këtë projekt çdo cep i territorit të Kosovës do ta ketë rrjetin sekondar. Natyrisht se kemi me i plotësuar edhe disa vende disa lagje, ka rrjet në katunde mirëpo nuk kem arritë me e dërguar, bashkë me kompaninë do të punojmë në këtë drejtim, dhe ideja tjetër ka qenë kjo, se duhet me e pasur parasysh edhe kohën, unë ende po besojë se procedurat kanë me u zhvilluar normalisht. Do të kërkojmë afate të përshpejtuara në mënyrë që ta përmbyllim se kjo duhet me u përfunduar në fund të vitit. D.m.th. kemi marrë pak rrezik mbi vete, se më komode ka qenë me i dërguar në Mallra dhe Shërbime me i shpërndarë dhe me pas kokën rehat. Projekti tjetër është rruga bashkë me rrethin këtu në fillim të Istogut, se ai projekti që është kontrata e nënshkruar i shesheve këtu në Istog, fillon nga pjesa e poshtme aty tash që është ajo pompa e vjetër, vjen qendra vazhdon këtu e deri në pjesën të 'Bajram Curri' ai projekt veç ka filluar, mirëpo rruga 'Rinia' që shkon nga Gjumnazi edhe aty ka përfunduar aty janë me mjete tona që i kemi bërë ne, kanë filluar procedurat sa di unë edhe kontrata është nënshkruar dhe të fillojnë punimet. Por ideja ka qenë a e keni parë që atje tash është duke u punuar një gyp i kanalizimit që është prej pjesës së poshtme nën 'Troftë' diku gyp kolektor ta quaj d.m.th. është qit i ri, tash prej rrethit, bashkë me rrethin kemi vendos aty ta bëjmë një rreth, do të jetë një rreth i mirë në hyrje të Istogut ashtu ka dalë hapësira është e mjaftueshme, dhe ai rreth do t'i ketë tash krahun andej ka 'Trofta' duke e bërë daljen këtu skaj varrezave, mbi palestër, rrugë komplet e re me 3 shtresa, kanalizim të ujerave, me gjithë ato infrastrukturat me ndriçim anash, në mënyrë që edhe pjesa nga Gjumnazi bashkohen me rrethin dhe atëherë ky do të fillojë menjëherë punimet, ngjitet lartë mbi rreth dhe vjen deri te qendra në Istog këtu, nuk ka mjete shumë në atë projekt, këto janë projekte të ndara dhe duhet me procedurë të re me e bë këtë punë. Kjo ka qenë dhe unë llogaris dhe besojë që mundemi me qenë pak efikas në procedura dhe koxha i bindur jam që deri në fund të Dhjetorit që këto afate kemi me i përfunduar, sidomos ujësjellësi aty, në ujësjellës kushtet atmosferike lejojnë punën, është më lehtë me punuar, e shpërndarja e gypave mundet me u bë edhe në sezona dimërore, kështu që ajo është projekt më i favorshëm , pra kjo është ajo çka desha me ja u thënë që në fillim. Dikush do të pyet pse? Do të kishte ide me i dërguar këto mjete kudo mirë kishte qenë, ka rastis nuk kemi llogarit në këto mjete, janë projekte në vazhdim,

janë projekte të koduara, ky thirrjet projekti 'Rrugët e Istogut' ai thirrjet ujësjellësi i 'Mbi vadës' kështu që inkorporohen në këto dy projekte mirëpo procedurat janë të ndara d.m.th. të veçanta, nuk mundemi automatikisht kompanitë që janë duke i kryer këto punë me ja u dhënë në mënyrë direkte duhet të ketë konkurrencë.

Kryesuesi, faleminderit Kryetar! Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj, faleminderit Kryesues për fjalën! Përsëritës Kryetarin dhe të gjithë të pranishmit! Unë kisha një pyetje, d.m.th. pasqyri aty që nga këto mjete janë ndarë edhe 50,000.00 € për Arsim duke e marrë parasysh kushtet në të cilat po insistohet me filluar viti shkollor dhe gjitha ato shpenzime të cilat janë faktikisht përcjellëse nëpër shkolla në qoftë se mendohet qoftë fizikisht qoftë edhe online me e filluar vitin shkollor veç kisha dashtë me e bërë pyetje a mjaftojnë këto mjete për me e zhvilluar procesin mësimor d.m.th. nëpër shkolla përfshirë dezinfektimet , këto mjetet tjera të cilat faktikisht e përcjellin fillimin e vitit shkollor. Faleminderit!

Kryesuesi, faleminderit Ajshe!

Kryetari, nëse i keni përcjellë takimet e fundit që kanë pas, e përmendi një takim aty, për Komuna do të ketë 10 milionë euro shtesë plus 29 milionë tjera që janë ekskluzivisht për Komuna, kryesisht do të shkojnë në projekte rreth arsimit, rreth pandemisë rreth shëndetësisë, prandaj kemi qenë pak të rezervuar këtu, pse mos të merret dikush tjetër më shumë se ne, d.m.th. në asnjë mënyrë, se kemi edhe kapacitete të tjera që Arsimin nuk do ta lëmë në infrastrukturë jemi koxha të gatshëm këtu është edhe drejtori mund t'i jap shpjegimet e veta, jemi mjaft të përgatitur për këtë periudhë të pandemisë ta tejkalojmë bile më mirë se çka dikush mendon, d.m.th. për arsye se është menaxhuar mirë deri tash edhe nuk e kemi lënë për shkak të mjeteve. Te e fundit nëse vërtet na mungojë mjetet, ne marrim vendim ekstra mbledhemi këtu edhe i heqim diku tjetër edhe nuk e lëmë. Unë nuk po shoh ndonjë rrezik këtu.

Kryesuesi, Labinot Aliaj e ka kërkuar fjalën.

Labinot Aliaj, faleminderit Kryesues! I nderuar Kryetar, drejtorë dhe kolegë asambleistë. Sot jemi thirr në këtë mbledhje të jashtëzakonshme për Ri-alokimin e mjeteve prej 638,187.00 €, nga rezervat. Unë e pata një pyetje për Kryetarin, d.m.th. në këtë shumë prej 638,187.00 €, a nuk mundet me i gjetur të paktën këto 38,000.00 €, që të shkojnë për projektin e kanalizimit për fshatin, Shushicë e Ulët'? Ky premtim u bë nga Kryetari në vitin e kaluar që në këtë vit do t'i gjejmë mjetet, d.m.th. është momenti më i mirë që në këtë shumë 638,187.00 €, t'i gjejmë këto mjete dhe ta përfundojmë këtë rrjet të kanalizimit për fshatin 'Shushicë prej lagjes 'Metaj' deri te 'Aliajt' lartë. Pyetjen e dytë që e pata për Kryetarin që e dha një sqarim të mirë po nuk arrita me kuptuar për arsye se tha se me kompaninë që është duke i përfunduar punët e rrjeteve të sistemit të ujit i kemi paraparë d.m.th. këtë sistemin sekondar këto

250,000.00 € të shkojnë në këto fshatrat ku nuk ka sistem sekondar. Desha me pyet këto 250,000.00 € e dhe një sqarim po nuk arrita mirë me kuptuar a do të shkojnë direkt te kompania që është duke e kryer sistemin e ujit apo do të jetë në tenderim si fazë e re kjo? D.m.th. veç këtë pyetje nëse kishte pasur mundësi me sqaruar.

Kryetari, është procedurë e re. Fazë e re, unë e thashë edhe për atë edhe për këtë, d.m.th. është procedurë e re, nuk do të jetë ajo kompani hiç, se kontratën Komuna e ka me Austriak këtë projektin këtu ,Austriakët e kanë përzgjedh një kompani tjetër të Prishtinës që i ka marrë gati krejt projektet në Kosovë që i kanë përfunduar, e nuk ka pas shanse që unë me ndikuar aty, ky është problemi. Mirëpo kjo është projekt tjetër, këtë nuk e kam llogaritur unë sivjet me e bë hiç, nuk i kam bërë hesap unë këto, se nuk e dija a do të përfundojë ky projekt se ky e ka kontratën deri në Prill të vitit të ardhshëm, d.m.th. kjo kompania që po punon për ujësjellësin qendror, por është përafruar e ka dhënë premtimin që deri në Dhjetor ka me përfunduar. Edhe unë desha me e shfrytëzuar rastin në mënyrë që mos t'i lëmë për vitin e ardhshëm por t'i përfundojmë në këtë vit në mënyrë që të jetë komplet projekti i kompletuar, kjo është ideja, që njerëzit kur të lëshohet uji prej Burimit të Istogut ta kenë nëse jo në shtëpi atëherë kompania ka me i lidhur shtëpitë vet, kompania bile ta ketë në mëhallë. E ajo aty ma thuaj ti ku me i marrë prej këtyre me i dërguar te kanalizimi yt? Cilat i kishe hequr ti prej këtyre që ja u propozova unë këtu. Edhe është projekt i ri nuk mundesh me i fut, edhe këtë e shpjegova në fillim.

Kryesuesi, faleminderit Kryetar! Fjalën e ka kërkuar Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj, përshëndetje për të gjithë. Unë e mora fjalën veç për me e falënderuar Kryetarin për këto dy projekte edhe destinimin e këtyre mjeteve, kështu që e përgëzojë edhe për ato fshatra Kërrninat-Padalishtë-Suhogerllë-Cerkolezë, që nuk i ka lënë që kur të lëshohet gypi mos të kanë ujë ata. Kështu që veç desha me e falënderuar një falënderim të jashtëzakonshëm për këto fshatra që po e bën punën e jashtëzakonshme. Faleminderit!

Kryesuesi, faleminderit Naim! A e dëshiron dikush tjetër fjalën?
Eliot Kukiqi është lajmëruar.

Eliot Kukiqi, përshëndetje! Unë vetëm e pata një pyetje, nëse nuk shpenzohen me kohë këto mjete për këto projekte a tërhiqen prej Qeverie? Nëse nuk mund të realizohen me kohë?

Kryetari, po humbin. Duhet të demonstrojmë seriozitet, të krijojmë relacione të mira edhe të bëjmë procedura të rregullta, me përkrahje të të gjithë njerëzve edhe të tuajën këtu, se unë e di çfarë propaganda bëhen, jo si e dërgoi, shih çfarë bëri këtu njëqind mijë pallavra unë atë e di, se nuk mundem me ja mbyllë gojën askujt, unë po ju tregoj që këto munden me humb, e aty natyrisht që këto me humb, krejt keni me

thënë fajet i ka Kryetari, po e marrë edhe këtë punë nuk kam çka me thënë ndryshe, nuk mundem unë me thënë para juve fajet i ka Jashar Blakaj ose i ka Enver Rugova se nuk mundem se dal jo serioz, i kam unë.

Kryesuesi, faleminderit Kryetar! Dikush tjetër a e dëshiron fjalën?
Naim Imeraj është lajmëruar.

Naim Imeraj, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Duke u marrë parasysh se u elaborua ajo çka u tha. Po më intereson çështja e këtyre 68,187.00 €, të fundit në rangim a ka projekte rrjedhëse në të cilat këto apo është një luftë që me pas mundësi prej rishikimit të buxhetit me pas projekte në të cilat ne bashkëparticipojmë, se po shihet që kjo është bashkëparticipim. Nuk e di a isha i qartë. Faleminderit!

Kryesuesi, faleminderit Naim! Urdhëro drejtor.

Hysni Maxharraj, planin në këtë projekt kryesisht e kemi prej të hyrave vetanake. Të gjithë jemi në dijeni që jemi në një vit që është një realizim i ulët i të hyrave vetanake, e kemi një projekt të madh që e kemi nënshkruar d.m.th janë hap procedurat edhe janë përfunduar asfaltimi i rrugës në zonën industriale në Istog, ku në atë projekt janë 175,000.00€ ku 94,000.00€ janë prej projektit për participim dhe kemi kërkesa të ndryshme të mëdha që vijnë si nga komuniteti, si nga donatorët tjerë si nga Ministritë e linjës që po paraqiten nevoja që duhet me i përkrah me participim, edhe këtu e kemi paraparë t'i alokojmë këto mjete.

Kryesuesi, faleminderit drejtor! Dikush tjetër a e dëshiron fjalën?
Urdhëro Jehonë Haxhijaj.

Jehonë Haxhijaj, Përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë pak isha ndërlidh me Labinotin, ai e pati një projekt të vetin që tha me i tërheq disa mjete prej këtyre rezervave dhe me ja realizuar disa projekte. Edhe unë pak a shumë si ky por me një shumë tepër të vogël, kërkoj që tek pika ndërtimi i rrugëve ku janë ndarë 250,000.00 € të tërhiqet një shumë tepër e vogël 3,000.00€ -5,000.00€ nuk besojë që është më e lartë edhe të rregullohet rruga për bjeshkën e Vojdullit meqë është më shumë se e nevojshme edhe është kërkesë që dy muaj edhe është duke vazhduar ende, janë duke kërkuar banorët për me e rregulluar këtë rrugë. Kështu që kisha kërkuar nuk vërehet sepse është një shumë tepër e vogël.

Kryesuesi, Besojë që mund të gjinden edhe diku tjetër ato, a është rrugë e re ajo a çka?

Jehonë Haxhijaj, kjo rruga ekzistuese për fshatin Uçë, po Kryetar i kam parë fotot që ke qenë bashkë me Naimin edhe kom menduar që ka me u zgjidh ky problem, mirëpo nuk është zgjidh, i pashë kërkesat e banorëve tek mediat lokale, prapë edhe

mua më kanë shkruar të lutem bëje kërkesën, edhe pse ishte kjo mbledhje e jashtëzakonshme e thashë ndoshta nuk e kam mundësinë me e bërë këtë kërkesë, por pasi që Labi me hapi rrugë atëherë edhe unë e bëra kërkesën, në këtë rast e falënderojë Labin se ndoshta nuk e kisha bërë.

Kryetari, ne e kemi shpallë mirëmbajtjen e rrugëve malore, e kem pas heq atëherë por e kem veç nuk e kanë aprovuar, tash me këtë mirëmbajtjen që është në procedurë edhe me disa rrugë atje tash i kemi kthyer ato mjete në bazë të propozimit që ka qenë për këtë vit prej buxhetit që e kemi aprovuar vitin e kaluar, kështu që duhet me shikuar aty mundësinë me e bë edhe atë sqarim, nuk ishte edhe aq tragjike sa po e thuani ju se e kam parë edhe vet.

Jehonë Haxhijaj, më fal kryetar, nuk e kanë luksin banorët e asaj ane që me shkuar nëpër Bogë e Prevallë e duhet me shkuar në atë bjeshkën e tyre, kështu që ty të doket që nuk ishte aq tragjike por me ndodhë ndonjë aksident, a rrezikohet jeta e dikujt...

Kryetari, unë po flas për atë çka e kam parë unë me sytë e mi, jo çka më është dukur mua.

Jehonë Haxhijaj, kryetar aty me fëmijë udhëtojnë, kalojnë asaj rruge bashkë me fëmijë e pak është shqetësuese, nuk është bash asgjë qysh po e bën.

Kryetari, ajo nuk e ka standardin i ka disa kthesa goxha të rrezikshme unë e di edhe atë punë, këtë duhet ta kesh parasysh ajo është fakt, ashtu është e Studenices ashtu është e Kaliqanit, përveç këtyre dy rrugëve kryesore që janë hapur, që i plotësojnë disa kriteret të rrugës tamam standarde, tjerat rrugë nuk janë. Ku ke parë me bërë rrugën Vojdullë prej Uçe me 5,000.00€ nuk ka rrugë me 5,000.00€ jo se është dashtë me i bë 50 leqe aty për me e zgjatë që me pas mundësi me shkuar tamam komod.

Jehonë Haxhijaj, për momentin po kërkohet veç rregullimi dhe mirëmbajtja, për momentin nuk po kërkohet me e asfaltuar, por me i evituar ato dëmtime edhe me ja u dhënë mundësinë me udhëtuar me qetë dhe më lirshëm. Unë kërkesën e atyre banorëve e adresova tek ju, tash mbetet në ndërgjegjen e juaj nëse e realizoni ose jo. D.m.th. si mundësi tek ndërtimi i rrugëve me tërheq pak mjete me e realizuar. Faleminderit se e zgjata!

Kryesuesi, nuk është lajmëruar më askush për fjalën, besoj se u qartësua.

Në sallë jemi 23 anëtarë të Kuvendit meqë nuk është lajmëruar më askush pyes të gjithë anëtarët e Kuvendit kush është që të miratohet ky Propozim -Vendim i Kryetarit të Komunës për Ridestinimin e këtyre mjeteve bazuar në elaborimet që u dhanë.

Kush është për?

Konstatohet se në mënyrë unanime anëtarët prezentë të Kuvendit në takim gjithsej 23 (njëzet e tre) miratuan Propozim-Vendimin e Kryetarit të Komunës për Ridestinimin e atyre mjeteve rezervë

Kryesuesi, ju faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në takimin e ardhshëm.

Mbledhja përfundoi me punë në orën 10:48.

Procesmbajtëse,
znj. Flora Bujupaj



Kryesuesi i Kuvendit,
z. Qaush Balaj

